

11 mars 2026,
Prishtinë

Bazuar në Rregulloren Disiplinore të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) të datës 30.08.2023, si dhe në trajtim të kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të datës 04.03.2026, Komisioni Disiplinor i FBK-së (“KD”), me datë 11.03.2026 merr këtë:

V E N D I M

- I. SHQIPTOHET vërejtje ndaj trajnerit Dritëro Sefaja, për shkelje të lehtë disiplinore sipas Nenit 48(2)(b) të Rregullores Disiplinore të FBK-së;
- II. Masa ka efekt ndalues dhe edukues, me qëllim të parandalimit të çdo sjelljeje të ngjashme që mund të cenojë rregullin, respektin dhe integritetin e aktiviteteve sportive të organizuara nga FBK, veçanërisht në garat e kategorive të reja;
- III. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Më datë 04.03.2026, Komisioni Disiplinor i FBK-së (“KD”), përmes postës elektronike, ka pranuar kërkesën për inicim të procedurës disiplinore ndaj trajnerit të KB Kerasan, Dritëro Sefaja (tash e tutje “Kërkesa”), e cila ka të bëjë me supozimin për shkelje të lehtë lidhur me garat, nga trajneri i KB Kerasan, në ndeshjen e zhvilluar me datë 21 shkurt 2026, ndërmjet KB Kerasan dhe KB Illyrian.

Ashtu siç përcaktohet me aktet në fuqi, KD, më qëllim që menjëherë të filloj me shqyrtimin e fakteve dhe provave në procedurën disiplinore, me datën 09.03.2026, në orën 17:00, ka mbajtur takimin e parë shqyrtues, me ç’rast ka dizajnuar administrimin e procesit për të vlerësuar faktet dhe rrethanat e ngjarjes që janë të nevojshme për marrjen e vendimit. Në kuadër të këtij takimi, KD, në përbërje të plotë dhe aprovim të të gjithë anëtarëve vendosi që për qëllime të verifikimit të fakteve dhe në zbatim të drejtë të Rregullores Disiplinore të FBK-së, duke zbatuar nenin 38 të Rregullores Disiplinore, nëpërmjet administratës së FBK-së, t’i kërkohet deklaratë me shkrim palës ndaj të cilit është iniciuar procedura, si dhe gjyqtarëve dhe vëzhguesit të ndeshjes.

Më datën 10.03.2026, KD, nëpërmjet email-it, sipas kërkesës, ka pranuar deklaratat nga trajneri Sefaja dhe dy gjyqtarët e ndeshjes.

Në funksion të trajtimit të lëndës, përveç takimit të datës 09.03.2026, KD ka mbajtur takim edhe me datë 11.03.2026, ku ka shqyrtuar deklaratat me shkrim dhe provat e tjera të administruara nga sekretaria. Gjatë shqyrtimit, KD ka analizuar të gjitha dokumentet dhe provat në dispozicion, bazën ligjore, si dhe rregullativën e brendshme të FBK-së, dhe ka konstatuar si në dispozitiv për arsyet e mëposhtme.

Gjatë shqyrtimit të rastit, KD ka vlerësuar se sjellja e trajnerit në situatën konkrete përbën veprim që tregon mungesë respekti ndaj personave të përfshirë në aktivitetin sportiv. Megjithatë, nga shqyrtimi i deklaratave dhe rrethanave të ngjarjes është konstatuar se trajneri ka pranuar veprimet e tij dhe ka shprehur keqardhje për situatën e krijuar.

Komisioni ka marrë në konsideratë edhe rrethanat në të cilat ka ndodhur incidenti, përfshirë reagimin e papërshtatshëm të një prindi të pranishëm në ndeshje, i cili sipas deklaratave të paraqitura ka ndikuar në tensionimin e situatës. Gjithashtu është vlerësuar fakti se gjyqtarët e ndeshjes e kanë ndëshkuar trajnerin me gabim teknik, duke mos vlerësuar se situata kërkonte përjashtimin e tij nga loja.

Në vlerësimin juridik të rastit, KD ka konstatuar se dispozita përkatëse që trajton situatën në fjalë është Neni 48, paragrafi 2, pika (b) i Rregullores Disiplinore të FBK-së, i cili përcakton:

2. Shkelje të lehta në lidhje me garat, dhunën dhe dukuritë e tjera negative në sport konsiderohen këto si në vijim:

[...]

(b) Ofendimi ose veprime që tregojnë mungesë respekti ndaj një anëtarit të ekipit, një tjetër individit, publiku, apo çdo person tjetër, e që nuk përbën një shkelje të rëndë.

Pas analizës së plotë të provave dhe deklaratave të administruara në procedurë, KD ka vlerësuar se veprimet e trajnerit përbëjnë shkelje të lehtë disiplinore sipas kësaj dispozite.

Në përcaktimin e masës disiplinore, KD ka marrë parasysh edhe rrethanat lehtësuese në përputhje me Nenin 25 të Rregullores Disiplinore të FBK-së, i cili parasheh se qëllimi i dënimit mund të arrihet me një masë më të butë kur ekzistojnë rrethana që e justifikojnë një qasje të tillë. Në rastin konkret, KD ka vlerësuar si rrethana lehtësuese:

- faktin se kjo është hera e parë që trajneri paraqitet para Komisionit Disiplinor;
- kontributin shumëvjeçar të tij në sportin e basketbollit;
- faktin se trajneri ka pranuar përgjegjësinë dhe ka shprehur keqardhje për veprimet e tij;


- rrethanat e situatës konkrete, përfshirë edhe provokimin e situatës nga reagimi i një prindi, që sipas deklaratave ka ndikuar në përshkallëzimin e incidentit.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, si dhe parimin e proporcionalitetit, KD ka vlerësuar se masa e vërejtjes është masa më e drejtë dhe e përshtatshme në këtë rast. Përmes kësaj mase synohet të dërgohet një mesazh i qartë se sjellje të tilla nuk janë të pranueshme, veçanërisht në aktivitetet sportive që përfshijnë kategori të reja. Gjithashtu, masa ruan karakterin edukues, parandalues dhe korrigjues të dënimeve, sipas Nenit 13 të Rregullores Disiplinore, duke siguruar mbrojtjen e interesit të përgjithshëm dhe vlerave të sportit të basketbollit.

Komisioni thekson se kjo është masa e parë disiplinore e shqiptuar ndaj trajnerit Sefaja, dhe se çdo përsëritje e sjelljeve të ngjashme ose çdo shkelje tjetër disiplinore do të trajtohet pa tolerancë, duke aplikuar masa më të rrepta sipas dispozitave të Rregullores Disiplinore.

Bazuar në të gjitha si më sipër, Komisioni Disiplinor vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Disiplinor:



Afrim Kamishi
Anëtar



Omer Daku
Kryetar



Blerim Vuniqi
Anëtar

Prishtinë, 11 mars 2026

Vendimi i dërgohet:

- z. Dritëro Sefaja
- Anëtarëve të Komisionit Disiplinor
- Komesarit të Garave për Kategoritë e Reja
- Arkivit të FBK-së



Këshilla Juridike:

Kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë mund të parashtrohet ankesë në afat prej 3 ditë (pune), duke llogaritur nga dita e përcjelljes së vendimit përmes postës elektronike, kurse i paraqitet Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit. Me rastin e paraqitjes së ankesës, paraqitësi duhet të paguaj në llogari të FBK taksën prej 300€, mjete të cilat i kthehen paraqitësit nëse i miratohet ankesa.